

**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP - Buletin periodik 01
Qershor 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Kuvendi i Shqipërisë, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Kuvendit, në zbatim të rekomandimeve progresraportit të BE-së dhe raportit *screening* të Komisionit Evropian 2023, si dhe në deklaratat/rezolutat e Samitit për Demokraci të SHBA-së, më datë 27.5.2024 miratoi Rezolutën e Kuvendit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, (Rezoluta e Kuvendit).

Në zbatim të kësaj Rezolute, Kuvendi me vendimin nr.50, datë 30.5.2024, vendosi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” (vendimi nr.50/2024 – më poshtë “Komisioni i Posaçëm Parlamentar”) dhe me vendimin nr.53, datë 6.6.2024 të Kuvendit, u vendos përbërja e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar (vendimi nr.53/2024). Sipas formulës së miratuar, shumica parlamentare përfaqësohet nga 6 anëtarë (E. Gjonaj, E. Shalsi, E. Kushi, F. Xhafaj, K. Bushka dhe T. Gogu) ndërsa pakica parlamentare nga 5 anëtarë (Dh. Tyli, F. Aça, J. Tabaku, S. Koti, ...). Anëtarë zëvendësues nga shumica parlamentare janë M.Ekonomi dhe E.Braçe, ndërsa pakica nuk i ka përcaktuar anëtarët e saj zëvendësues. Mbështetur në Rregulloren e Kuvendit, kryetar është caktuar z. Fatmir Xhafaj, ndërsa nënkryetari duhet të propozohet nga opozita.

Në këto kushte, bazuar në nenet 7, 77, pika 1, 78 dhe 80, pika 3, të Kushtetutës dhe të neneve 24 e vijues të Rregullores së Kuvendit, në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të datës 27.05.2024 dhe në funksion të zbatimit të vendimit nr. 50/2024 dhe vendimit nr. 53/2024, më datë 14.06.2024 u zhvillua mbledhja e parë për konstituimin e këtij Komisioni të Posaçëm të Kuvendit. Për zhvillimin e mbledhjes, sipas Rregullores, nga stafi i Kuvendit u njoftuan të gjithë anëtarët e Komisionit, mazhorancës dhe opozitës. Mbledhja u drejtua nga Kryetari i Komisionit, z.Fatmir Xhafaj.

Konstituimi i Komisionit të Posaçëm u përshëndet nga Kryetarja e Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, e cila theksoi mbështetjen e plotë institucionale të Kuvendit dhe të saj për veprimtarinë e Komisionit. Kryetarja Nikolla, theksoi se: “Është detyra jonë të lexojmë me kujdes përvojën e zbatimit të reformave gjatë dekadës së fundit, dhe t'i propozojmë Kuvendit dhe qytetarëve shqiptarë ndryshime ligjore dhe institucionale, në mënyrë që të gjithë sektorët e qeverisjes të ecin përpara me ritmet që kërkon koha, Shqipëria euroatlantike, qytetarët dhe partnerët tanë strategjikë.” Ajo shprehu besimin se opozita do të marrë pjesë dhe kontribuojë në këtë Komision, duke marrë përgjegjësitë e saj para qytetarëve, votuesve dhe Shqipërisë.

Në fillim të mbledhjes, Kryetari i Komisionit z. Fatmir Xhafaj, parashtroi se vendimi i Kuvendit për funksionimin e Komisionit të Posaçëm ka përcaktuar qartë objektin, fushën e veprimit, instrumentet dhe mekanizmat e funksionimit,

duke evidentuar qartë detyrimin për adresimin e disa sfidave të rëndësishme në interes të qytetarëve, në funksion të procesit të integritit evropian të vendit dhe synimit madhor për të qenë vend anëtar në BE në vitin 2030. Z. Xhafaj shprehu bindjen se veprimtaria e Komisionit do të ndërtohet bazuar në një proces gjithëpërfshirës në rrafshin politik, institucional dhe social, dhe në këtë kontekst, roli i opozitës është shumë i rëndësishëm për qëllimet që do të adresojë kjo reformë. Gjithashtu, Z. Xhafaj nënvizoi se procesi do të duhet të ecë përpara duke qenë gjithëpërfshirës, transparent, profesional dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, me përfshirjen e të gjithë aktorëve dhe faktorëve politikë e socialë, shoqërisë civile, botës akademike, biznesit, grupeve të interesit, si edhe i asistuar me ekspertizën më të mirë vendase e ndërkombëtare dhe mbështetur edhe në përvojën e suksesshme me Reformën në Drejtësi.

Ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Elisa Spiropali, e ftuar në këtë mbledhje, në emër të Këshillit të Ministrave theksoi gatishmërinë për të mbështetur veprimtarinë e Komisionit me burime njerëzore, dokumente e të dhëna të ndryshme, duke respektuar parimin e ndarjes dhe balancës ndërmjet pushteteve. Ajo e vlerësoi rolin e këtij Komisioni edhe si një kontribut shtesë shumë të rëndësishëm në mbështetje të vullnetit të shtetit shqiptar, interesit të qytetarëve dhe objektivave e agjendës ambicioze të qeverisë në procesin e integritit evropian.

Në vijim, Komisioni i Posaçëm mori pesë vendime të natyrës përgatitore e organizative, me synim përgatitjen e procesit dhe hapave të mëtejshëm që do të ndiqen. Vendimet u miratuan me unanimitet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Komisioni i Posaçëm, në pesë vendimet e miratuara, vendosi si më poshtë:

1. Për të siguruar efektivitet sa më të mirë të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm, në përmbushje të misionit të tij, duke mbajtur në konsideratë objektin e gjerë dhe kohën në dispozicion për ushtrimin e mandatit të Komisionit, anëtarët e tij dhe sidomos Grupi i Ekspertëve dhe Sekretariati Teknik, do të organizohen në tre nëngrupe që do të angazhohen për tre fushat kryesore të veprimtarisë së këtij komisioni. Nëngrupet kryesore janë: i) Mirëqeverisja; ii) Antikorrupsioni, dhe iii) Sundimi i ligjit.
2. T'u drejtohet me një ftesë për bashkëpunim organizatave të shoqërisë civile, organizatave të biznesit, botës akademike (universiteteve publike e jopublike) dhe grupeve të interesit për të shprehur interesin për përfshirje në nivel ekspertësh në përbërje të Grupit të Ekspertëve dhe në Sekretariatit Teknik, angazhim në tryezat e debatit publik, si dhe për të kontribuar me dokumente e të dhëna të ndryshme të krijuara në 5 vitet e fundit për fushat që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së këtij Komisioni.
3. T'u drejtohet institucioneve të pavarura që krijohen nga Kuvendi, si: (Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioni i Prokurimit Publik, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Instituti i Statistikave etj.) dhe agjencive ekzekutive ligjzbatuese, si: Agjencia e Inteligjencës Financiare, Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale (DPD), Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) (DPT), Policia e Shtetit (Drejtoria e Kriminologjisë, Drejtoria e Hetimit të Kriminologjisë dhe Hetimit të Kriminologjisë), Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, Inspektorati Qendror (KM), Drejtoria e Auditimit (KM), Agjencia e Prokurimeve Publike (KM) etj.), që të propozojnë emrat e përfaqësuesve/ekspertëve me të cilët do të përfaqësohen për të bashkëpunuar dhe kontribuar me ekspertizën e tyre pranë grupeve të punës të Komisionit të Posaçëm.
4. T'u kërkojë Kuvendit, Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministres së Shtetit për Integrimin Evropian dhe Kryenegociatore, Ministres së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrin të Shtetit për Qeverisjen Vendore, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që të mundësojnë që specialistë të stafeve të tyre, të përshtatshëm për qëllimin dhe objektin e punës së këtij Komisioni, të mund të bëhen pjesë e Sekretariatit Teknik, i cili do të funksionojë në mbështetje të Grupit të Ekspertëve pranë Komisionit të Posaçëm.

5. Ti kërkojë Kuvendit, Ministres së Shtetit dhe Kryenegociatore, Ministres për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrit të Shtetit për Qeverisjen Vendore, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që të vënë në dispozicion të Grupit të Ekspertëve dokumente pune dhe të dhëna të ndryshme që disponojnë dhe që mund të shërbejnë për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së këtij Komisioni.

Më datë 21.06.2024 Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi mbledhjen e tij të dytë duke marrë disa vendime të rëndësishme të natyrës organizative, gjithmonë në funksion të përgatitjes së procesit. Vendimet e mbledhjes ishin si më poshtë vijon:

1. Ftesë publike për bashkëpunim për organizatat ndërkombëtare që veprojnë brenda dhe jashtë vendit, si dhe për individët, ekspertët vendas e ndërkombëtarë, si dhe për ekspertë, shtetas shqiptarë në diasporë me përvojë në fushat përkatëse, për të kontribuar me ekspertizën e tyre, si konsulentë të GE-së, në përmbushje të qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
2. Kërkesë drejtuar disa institucioneve që veprojnë në sektorë me risk për korrupsion (prokurimi publik, koncesionet, pronat, tatimet, doganat, shëndetësia, arsimi etj.), për t'u përfaqësuar me përfaqësues/ekspertë pranë Nëngrupit të punës për Antikorrupsion të ngritur në Komisionin e Posaçëm Parlamentar.
3. Miratimi i organigramës së Sekretariatit Teknik.
4. Miratimi i Konceptit për ndërtimin e faqes *online* dhe Platformës së Komunikimit publik.

Në total, në dy mbledhjet e para janë marrë gjithsej 9 vendime, tërësisht të natyrës organizative e teknike, pjesë e fazës përgatitore të procesit. Në vazhdim ka vijuar puna për zbatimin e vendimeve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, përgatitja dhe shpërndarja e ftesave për bashkëpunim për institucionet e mësipërme, si dhe përgatitja e kushteve të punës për Grupin e Ekspertëve dhe Sekretariatin Teknik.

Menjëherë pas ngritjes së Komisionit të Posaçëm, me porosi të Kryetares së Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm ka përcaktuar grupin e këshilltarëve e specialistëve nga radhët e stafit të Kuvendit, të cilët do të jenë pjesë aktive e Sekretariatit Teknik, si dhe Njësinë Mbështetëse që do merret me komunikimin publik e median, faqen *web* të Komisionit, kërkimin parlamentar, logjistikën e infrastrukturën etj.

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit korrik me agjendën e Komisionit?

Komisioni do të marrë vendime përgatitore e organizative lidhur me organizimin e menaxhimit e procesit në standardet përkatëse, siç janë ato për: i) ftesën për të gjitha grupet parlamentare, pjesë e opozitës parlamentare, që të propozojnë ekspertët e tyre pranë 3 nëngrupeve të GE-së dhe në Sekretariatit Teknik; ii) miratimin e përbërjes dhe drejtimit të Sekretariatit Teknik (bazuar në stafin e Kuvendit dhe propozimet e sjella nga institucionet); iii) miratimin e ekspertëve që do të propozohen nga universitetet, shoqëria civile dhe ndarjen e tyre në 3 nëngrupe; iv) miratimin e përmbajtjes së faqes *online* dhe platformës së komunikimit publik, si dhe thirrjes për përfshirjen e qytetarëve në debatin publik me komente e propozime; v) miratimin e konceptit dhe strukturën e dokumentit të analizës, që do të përgatitet nga ekspertët dhe burimet e të dhënave dhe dokumentet që do të shfrytëzohen për këtë qëllim; vi) miratimin e ftesës për bashkëpunim dhe përfaqësimit me ekspertë të institucioneve dhe organizatave që veprojnë në fushën e drejtësisë; vii) ftesës për bashkëpunim për përfaqësuesit e mediave kritike të angazhuara në këto fusha (si p.sh. “BIRN”, “Monitor” etj.).

Gjatë muajit korrik pritshmëria është që Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik në mbështetje të tij, të formatohen tërësisht dhe të përgatiten për hapat në vazhdim në përputhje me qëllimet e përcaktuara nga rezoluta e Kuvendit, objektin dhe metodologjinë e përcaktuar nga Kuvendi për Komisionin e Posaçëm parlamentar. Gjithashtu presim të marrim dhe shprehjet e interesit nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare apo përfaqësitë e tyre në Tiranë, si dhe të ekspertëve shqiptarë e ndërkombëtarë, të ftuar për të kontribuar me konsulencën e tyre të dobishme në këtë proces, pra Grupit të Ekspertëve shqiptarë të nivelit të lartë.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**